



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI
I MBAJTUR MË 25. 4. 2017**

T R A N S K R I P T

**SA JAVNE RASPRAVE KOMISIJE ZA EKONOMSKI RAZVOJ,
INFRASTRUKTURU, TRGOVINU I INDUSTRIJU
ODRŽANE 25. 04. 2017 GODINE**

PRILL, APRIL 2017

Mbledhjen e drejtoi kryesuesi i Grpit të punës - Komisioni për Zhvillim Ekonomik, z. Raif Qela

KRYESUESI: Të nderuar të pranishëm,

Po e fillojmë dëgjimin publik lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit numër 05/L-027 për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore.

Siç e dini ky ligj po thuaj se që dy vjet është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe duam ta dimë se deri ku ka arritur me zbatimin e tij.

Duke pasur parasysh se një pjesë e mediave nuk janë të pranishme, ne pritëm deri tani megjithëse nuk jemi të detyruar të presim edhe më tutje edhe ashtu jemi vonuar. Në përputhje me nevojat që të shihet deri ku ka arritur me zbatimin e Ligjit për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë Tregti dhe Industri si bartës i këtij ligji ka marrë një vendim që të formohet grup punues lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. Janë marrë disa prej hapave të nevojshëm që të grumbullojnë informacione se deri ku ka arritur me zbatimin e ligjit dhe sot e kemi në plan që në këtë dëgjim publik ta shohim se deri ku ka arritur zbatimi i këtij ligji.

Në këtë grup punues përveç deputetëve nga radhët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik janë edhe deputetë nga radhët e Komisionit për Administratë Publike Qeverisje Lokale dhe Media të cilat po ashtu janë pjesëmarrës të grupit punues.

Duke pasur parasysh se krejt ky proces i digjitalizimit është vonuar në Kosovë, duke pasur parasysh edhe siç shihet ka vonesa në zbatimin e këtij ligji tani dhe si proces po vazhdon të vonohet edhe më shumë. jemi këtu që t'i trajtojmë problemet që kanë të bëjnë me ligjin dhe pengesat që kanë dal prej ligjit në zbatimin e këtij procesi të digjitalizimit.

Kërkoj nga të gjithë ju të pranishmit që do ta merrni fjalën të prezantoheni sepse është e nevojshme për shkak të transkriptit të dihet se kush çka ka folur si dhe të bëjmë përpjekje ta bëjmë një debat sa më konstruktiv, mos t'i ndërhyhet njëri tjetër në fjalë deri sa t'ia jap fjalën të mos e merr fjalën askush.

Ju për të qenë shumë i rreptë por për shkak se shpeshherë po ka edhe përplasje të panevojshme.

Para se t'ua jep fjalën juve të pranishme të tjerë, së pari ja jep fjalën përfaqësueses së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, respektivisht kryetares së Komisionit zonjës Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, koleg i nderuar!

Përshëndetje për të gjithë që janë prezentë këtu,

Akterë të mediave,

Përshëndetje për përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur për Media,

Singerisht unë kam pritë që ka me pas interesim shumë më të madh, e kam pa që njoftimi ka shkua me kohë por nuk e di ndoshta kanë pas prioritete tjera po kisha pritë që paku përfaqësuesit e Industrisë Mediale me qenë prezentë sepse shpeshherë po i marrim vërejtjet vetëm përmes imellave realisht kur janë fizikisht këtu edhe i dëgjojnë mendoj që shumë më shumë munden me marrë praktika edhe opinionet e tyre kishin qenë shumë më drejtpërdrejta. Megjithatë unë respektoj prezencën e këtyre që janë këtu.

Më lejoni të theksoj që si kryetare e Komisionit për Administratë Publike Qeverisje Lokale dhe Media, ne kemi qenë shumë domethënë periferik të angazhuar në këtë drejtim për arsye se fillimisht është bartë si sponsorë prej Qeverisë në Ministrinë e Tregtisë edhe kështu ka shkua në Komision për Zhvillim ekonomik, pra jena me qasje shumë periferike.

Raifi ka shprehë dëshirën me qenë anëtarët e Komisionit por ne kemi ... krejt në fund domethënë qasja jonë ka qenë edhe në monitorim.

Ndërsa sa i përket dëgjimit publik është një praktikë e re që unë e përshëndes sepse nëse ka nevojë pse jo edhe me e ndryshua praktika, po zakonisht praktikat për dëgjime publike bëhen në momentin kur shihet që ka nevojë me ndryshua ligje. Unë nuk e kontestoj faktin që ligji ka pasur nevojë me qenë pak më ndryshe, domethënë i punuar për arsye që edhe nuk ka ndërlidhje shumë të mirë me çështjen e trajtimit të strategjisë e cila fatkeqësisht edhe ndoshta nuk u trajtua shumë seriozisht prej Qeverisë. Tu e ditë faktin që kanë kalua dy vite me gjithë kërkesat tona të herë pas hershme që ju keni pasur mundësi me i pa në Kuvend nuk është normale për një shtet me tentua me bë një kalim të strategjisë të digjitalizimit pa asnjë cent askund në botë nuk ndodh kjo, pra ose janë marrë mjete prej fondeve ndërkombëtare prej instrumenteve të ndryshme ose ka sponzorua Qeveria, po me tentua me kalua në proces të digjitalizimi nga analog pa asnjë cent domethënë duhet me qenë veç një ëndër kështu e keq e perealizueshme.

Çështja se si është trajtuar deri më tani nga Kuvendi mund të ju them që mënyrën tonë e kemi trajtua gjatë raportimit që ka pasur Komisioni i Pavarur për Media nënstop e kanë trajtua si temë e cila ka nevojë mu përkrahë, pra nuk është që KPM-ja nuk ka kërkuar mbështetje KPM-ja ka kërkuar mbështetje edhe në rastin kur ka bë dëgjime publike përherë kemi qenë të ftuar edhe të njoftuar.

Unë kisha dashtë me vlerësua punën e kryeshefes në këtë drejtim se mendoj që është zhvillua një transparencë në raport me industrinë edhe me aktorë që është dashtë me marrë pjesë, por realisht

këtë herë nuk ka qenë krah i fuqishëm, nuk ka qenë Qeveria dhe Kuvendi nuk ka mujtë me luajt rolin e vetë për arsye që buxheti ka qenë minimum ose hiq mund të them deri në këtë moment.

Unë konsideroj që ky dëgjim publik ka me na kontribuu që ne me dal së paku me një deklaratë të përbashkët, mirëpo edhe kemi me i pa vërejtjet nga individët edhe nga zyrtarët, edhe nga përfaqësuesit operator edhe të industrisë se ku qëndrojnë, sepse këta më së miri e dinë se çfarë lloj digjitalizimi neve na vynë si vend, domethënë me çka ne përshtatemi sepse ne kemi pa përvoja të shteteve të ndryshme po ne nuk përshtatemi as me buxhet as me karakterin gjeografik as me mënyrën qysh operojmë me disa nga to, po çka mundemi ne me implementua në bazë të këtij ligji po presim që të marrim ide.

Unë ju falënderoj për ftesën po presim kryetar të shohim se çka na thonë këta edhe të vazhdojmë edhe më tutje nëse do të mundemi me këtë ligj apo ka me pas nevojë me bë ndryshme në ligj, por me gjithat jemi në një fazë pak të ndishme duke ditë që KPM e ka përgatit materialin tenderues, ne presim që gjatë muajit me shkua por këta do të na tregojnë se ku ka ngecje, ku mundemi ne me ndihmua.

Po unë edhe një herë e theksoj nuk e ki sa kemi me pas mundësi, a do ta presim mu bë rishikimi i buxhetit për me tentua që ne me fitua një fond edhe me ja dedikua KPM-së duke ditë faktin që edhe rregulloret të cilat i kanë plotësua nuk kanë pasur mbështetje financiare, sinqerisht është e pakuptueshme po kërkesa ka shkua.

Për kaq për fillim. Faleminderit, ndoshta kyçna më vonë.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Izmaku!

Tani po jap fjalën me radhë.

Së pari kisha dashur ta dëgjoj fjalën e përfaqësuesve të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, a e doni fjalën ju lutem. Prezantohuni.

ENVER BASHA: Përshëndetje!

Unë jam Ever Basha, prej Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka qenë ministria sponzoruese e këtij ligji. Ligji për digjitalizim është kërkuar nga Ligji për KPM-në si e nevojshme, prandaj e kemi marrë ne atë bartë që ta bëjmë ligjin.

Ligji është bërë sipas Rregullores të paraparë për zhvillimin e akteve ligjore dhe është përfituar edhe asistentët teknikë e ...

Ne konsiderojmë se ky ligj është bërë siç duhet dhe ka pasur përmbajtjen e duhur deri në momentin kur e kemi dërguar ne në Kuvend por aty ka pësuar ndryshime dhe është dëmtuar

realizueshmëria e këtij ligji. Në përgjithësi ne mendojmë se, siç e kemi dhënë edhe përgjigjen me shkrim konsiderojmë se zbatimi i Ligjit për digjitalizim nuk është i kënaqshëm domethënë zero, konsiderojmë se për zbatim të ligjit përgjegjësi ... e ka Komisioni i Pavarur për Media dhe Kuvendi si organ ku jep përgjegjësinë KPM-ja. MZHE-si sponzorues i këtij ligji ka hartuar projektligjin dhe nenet përkatëse duke marrë në konsideratë realitetin dhe përvojat tona për të krijuar një balanc institucionale të domosdoshme për të siguruar zbatimin e këtij ligji.

Mirëpo, gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Kuvendit me lobimin e palëve të ndryshme të interesit kryesisht të KPM-së është arritur që të amendamentohen disa nene kritike të cilat e kanë dëmtuar modelin e funksionimit të procesit të planifikuar nga ne. Sidomos kjo ka të bëjë me ndryshimin e përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës dhe të relacionit të këtij komisionin me komisionin vlerësues. Amendamentet e bëra kanë shkarkuar nga përgjegjësia ministrinë dhe kanë vënë përgjegjëse kryesore vetëm KPM-në.

Prandaj, ne besojmë se adresa për përgjegjësinë dhe zbatimin apo moszbatimin duhet kërkuar në Kuvend – KPM.

Megjithatë MZHE konsideron se ligji është i zbatueshëm nëse merret roli dhe përgjegjësia e nevojshme nga përgjegjësit e definuar me këtë ligj.

Procesi i digjitalizimit dhe të transmetimeve radiotifuzive tokësore duhet të fillohet sa më parë aq më mirë, duhet të shpallet pakoja tenderuese dhe të testohet se a ka interes tregu.

Edhe sa i përket konstatimit të deputetes zonjës Izmaku, procesi i digjitalizimit nuk bëhet pa asnjë centë, është e kuptueshme se duhet KPM-ja, Qeveria ka shpenzime sa i përket hartimit të legjislacionit sekondar por vetë procesi i digjitalizimit ne që kemi dizajnuar siç e kemi planifikuar nuk ka pasur kosto, përkundrazi në atë kohë është pritur që të ketë përfitime nga dhënia e resurseve segmentore një operatori të rrjetit. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zota Basha!

Tani përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur të Mediave.

XHEMAJL KRASNIQI: Xhemajl Krasniqi, anëtar i Komisionit të Pavarur për Media.

I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Falënderoj shumë që jeni organizua një diskutim të tillë publik proces i digjitalizimit për mua si njeri i lëmisë është çështja më e rëndësishme që i takon këtij shteti për procesin e vulushmërisë së territorit në radiodifuzion.

Është obligim i shtetit që me kalua në procesin e digjitalizimit për shumë arsye, për arsye të vëllimit të procesit teknologjik në tërësi, për lirimit të brezit vrekfencor, për interesa tjera ekonomike edhe interesi kryesor publik është për informim sa më të mirë dhe sa më të lirë të të gjithë qytetarëve të vendit.

Procesi i transmetimit digjital radiodifuziv duhet të përfundoj duhet të përmbyllet, jemi të vonuar, jemi të vonuar shumë. këtu nuk është vetëm një fajtor ka shumë fajtor por nuk është me rëndësi ne të merremi me fajtorët po të merremi se si ta shtyjme procesin ta përfundojmë.

Unë jam i obliguar që të ju raportoj se çka ka bërë Komisioni i Pavarur i Mediave deri në këtë fazë që procesi i transmetimit digjital radiodifuziv të shkoj përpara. Kohë më parë KPM-ja ka përgatit strategjinë e cila e ka përshkrua teknikisht deri në detale mënyrën se si kalohet nga procesi i transmetimit analog në digjital për fat të keq sipas ligjit të KPM-së ajo është dashtë me u miratua prej Qeverisë dhe me qenë bazë për miratimin e Ligjit për transmetim radiodifuziv digjital. Unë s'kam indikacione që është marrë shumë parasysh strategjia e cila është dorëzua në Qeveri. Tash pas miratimit të ligjit me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore Komisioni i Pavarur i Mediave ka fillua me 8 dhjetor 2015 dhe e ka bërë publik planin për shfrytëzimin e radiofregjencave kanaleve të bazuara në kapitullin 8, neni 24 të Ligjit për digjitalizim numri i ligjit 05/L-027.

Më datën 14 dhjetor 2015 është konstatuar Komisioni Mbikëqyrës trup përgjegjës për mbikëqyrjen e tërë procesit të digjitalizimit. Për implementimin e Ligjit për digjitalizim Komisioni i Pavarur i Mediave ka miratua pesë rregullore përmes të cilave janë përcaktuar kushtet dhe kriteret për kalim nga transmetimi analog në atë digjital në Republikën e Kosovës.

Këto rregullore janë:

1. Rregulloret për operatorët e multipleksit në nivel shtetërorë,
2. Rregulloret për ofruesit e shërbimeve mediale audio vizuale,
3. Rregulloret për tarifën vjetore dhe për licencë,
4. Rregullore për bartjen e detyrueshme të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuele në operatorin e multipleksit, dhe
5. Rregullorja për renditjen logjike të kanaleve.

Procesi i hartimit të akteve të reja nënligjore ka qenë sfidë në shumë aspekte, mungesa e buxhetit të nevojshëm për KPM-në për implementimin e Ligjit për digjitalizim na ka shkaktua pengesën e realizimit me kohë të obligimeve ligjore edhe përkundër kësaj është arritur që me resurset ekzistuese me ekspertizën e brendshme të hartohen drafte të para të rregulloreve të reja, pastaj me ndihmën e siguruar përmes Komisionit Evropian zhvillohen më tej përmes konsulencës me një ekspert me qëllim që të sigurohen pajtueshmëria edhe me praktikën më të mira evropiane përveç pajtueshmërisë në bazën ligjore primare në Kosovë.

Me hyrjen në fuqi të këtyre rregulloreve që ka qenë kusht që KPM-ja pastaj të filloj përgatitjen e dokumentacionit plotësues përfshirë këtu edhe draft-vendimin për shpalljen e tenderit publik pakon tenderuese në mënyrë që të bëhet sa më shpejt shpallja e vendimit për koncesionimin e dy multipleksëve ashtu siç është përcaktuar në shtojcën e Ligjit për digjitalizim.

Ne si Komision presim që brenda gjashtë mujorit të parë të këtij viti të përfundohet puna dhe përgatitjen e materialit tenderues dhe të bëhet shpallja e vendimit për .. e tenderit publik.

Unë në këtë moment nuk kisha thënë diçka tjetër, këto janë ne çka kemi bërë si Komision i Pavarur i Mediave, nuk mendoj që e kemi bërë maksimumin e mundshëm por edhe që kemi ndejt duarkryq nuk besoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësues të ARKEPIT-it nuk ka, qysh po e shoh.

Tani dikush nga AMPEK-u, cili do prej jush.

ARDITA ZEJNULLAHU: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë jam Ardita Zejnullahu, prej AMPEK-ut. Asociacioni të Mediave Elektronike.

Nuk do të flas shumë më tepër Visari do ta bëjë analizën e implementimit ose më mirë mos implementimit të Ligjit për digjitalizimin, po në parim në përgjithësi mendoj se po hyhet në tërë këtë proces shumë kompleks edhe shumë të rëndësishëm pa një analizë të mirëfilltë të tregut edhe pa një rregullore e cila është kryciale për këtë proces ajo është Rregullorja e pronësisë edhe e koncentrimit të mediave.

Unë nuk e di se si KPM-ja do të menaxhoj procesin e tenderimit e mandej sigurisht edhe përzgjedhjes së fituesve të tenderit pa e ditë se cilët janë akterët kryesor në industrinë mediale në Kosovë. Rrezikojmë të shkojmë drejt monopolit nëse nuk e kemi një rregullore të tillë të miratuar para se të filloj i gjithë ky proces. Unë mendoj se KPM-ja është si bartës kryesor i procesit është edhe përgjegjësi kryesor për mos implementim. I kuptojmë të gjitha rrethanat në të cilat ata kanë funksionuar me gjithë atë të gjitha afatet ligjore të përcaktuara me këtë ligj janë tejkalua edhe janë shkel nga ana e KPM-së.

E dini edhe vetë se këto akte nënligjore të cilat i përmendi zoti Krasniqi të cilat i ka miratua KPM-ja është dashtë të miratohen në afat prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të ligjit.

KPM-së ju ka dashtë një vjet e gjysmë me i miratua këto akte nënligjore.

Tjetër çështje shumë brengosëse për ne është edhe që KPM-ja përkundër faktit që e përmendi edhe deputetja nga Komisioni për Media që nuk ka pasur shumë ndihmë sa i përket çështjes financiare pra buxhetit për me mendua qysh me e menaxhua gjithë këtë proces.

Por industria me vite të tëra ka thirrje KPM-së ose edhe ministrisë që të aplikojnë për fonde ... të Komisionit Evropian dhe të ndihmojnë edhe të ... procesin e digjitalizimit, një proces i këtillë përmes fondeve IPA është bërë prej Malit të Zi edhe Serbisë është digjitalizua tërë vendi prej këtyre fondeve. KPM-ja nuk e di për çfarë arsye kur nuk ka dashtë, s'ka qenë e gatshme të merret me këtë çështje, a është neglizhencë, a është padituri nuk mund të them, por sigurisht neglizhencë dhe përtaci e skajshme e tyre.

S'e di, desha edhe diçka tjetër të përmend. Ndoshta edhe çështja e menaxhimit tani të këtij procesi, e thirrjeve, po mendoj çështja e tenderimit të frekuencave dhe mënyra se si KPM-japo e menaxhon procesin është pak brengosësh dhe mendoje kjo industri nuk është shumë e madhe dhe njerëzit dihen dhe ato takaimë apo diskutimet publike të cilat bëhen për aktet nënligjore ose për çështjet që janë me rëndësi e të cilat KPM-ja duhet t'i miratojë, është e vërtetë se ftohen akterët, por sa merret parasysh prej rekomandimeve të cilat industria i bën apo edhe akterët tjerë mund të ju them se as 10% e atyre që propozohen nuk merren parasysh prej KPM-së.

Pra, është një mos transparencë totale në vendim marrje, absolutisht dhe vendimet kryesisht merren pre përfaqësuesve të KPM-së në takimet bilaterale që i kanë me paët e caktuara të interesit. Vendimet përfundimtare që kanë të bëjnë me aktet nënligjore merren në takime bilaterale, duke mundur të akomodohen interesat e palëve të caktuara të interesit.

Po e flas këtë për arsye se industria është shumë skeptike, mediat elektronike janë shumë skeptike për faktin se si e ka menaxhuar KPM-ja çështjen e funksionimit të operatorëve kabllorë. Ne sot e kësaj dite kemi mendoj shkelje të rregullores së operatorëve kabllor e cila bëhet në mënyrë flagrante dhe KPM-ja nuk është e gatshme as vërejtjen më të vogël t'ia dërgojë një operatori të caktuar.

Sinqerisht, këto janë shumë brengosëse për mënyrën se si funksionon ky institucion i cili në parim duhet të jetë i pavarur e tash me procesin e digjitalizimit i cili është shumë më kompleks se procesi, shembull i funksionimit të operatorëve kabllorë jemi shumë skeptikë se si do të shkojë i gjithë ky proces se sa do të ketë standarde të barabarta për të gjithë akterët.

Visari mund të diskutojë për më shumë çështje që kanë të bëjnë me aktet nënligjore...

KRYESUESI: Faleminderit zonja Zejnullahu! Urdhëro Visar!

VISAR HOTI: Jam Visar Hoti – AMPEK – Televizioni Tema.

Sa i përket funksionimit dhe implementimit të Ligjit të transmetimeve digjitale ne fillimisht kemi pasur vërejtje tona për mënyrën se si është plasuar ky ligj.

Pajtohem me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që ndoshta nuk është ligj perfekt, por vetëm aty pajtohem. E modeli i cili është prezantuar fillimisht prej kësaj ministrie... Ne kemi pasur për detyrën punën e Komisionit dhe takimet që i kemi pasur gjatë draftimit dhe imputi ynë ka qenë që ta parandalojmë apo zvogëlojmë një të keqe që është plasuar me raftin nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Pse po e them këtë? Drafti fillimisht i këtij ligji ka pas paraparë suprimimin e kompetencave të një kategorie kushtetuese që ka qenë Komisioni i Pavarur i Mediave.

Pra me atë ligj është paraparë që të merren kompetencat kushtetuese që i ka ky institucion. Dhe, prej aty kemi filluar këtë ligj ta ndryshojmë, ta sjellim diku ku është pak më ligj normal. Dhe nuk mund ta quajmë një ligj të mirë një ligj të tillë.

E pasi që kanë munguar edhe argumentet që Ministria e Zhvillimit Ekonomik kurrë s'i ka prezantuar te modelet ekonomike, çfarë kalkulimi ose para kalkulimi është bërë ose analiza e tregut është bërë dhe kush iu ka prezantuar publikut për draftin të cilin e kanë prezantuar aty. Pra ka munguar një transparencë e tillë. Dihet se nëpër modelet në Evropë kush i fillon digjitalizimet, është Rregullori, nganjëherë industria, është shteti. Janë këto 3 komponentë që nga vende të ndryshme kanë iniciuar digjitalizimin.

Po fakt se Kosova nuk ka të holla, mirëpo mediat kanë treguar një sensibilitet dhe kanë investuar për t'i bërë tekstet, për të bërë një ecje përpara, një detyrim ligjor që e ka Kosova që të transformojë nga transmetimi digjital analog në digjital. Disa vende tjera s'kanë miratuar ligj.

Thjeshtë e kanë bërë kalimin shumë thjeshtë. Po ne kemi tendencë nganjëherë që gjërat e thjeshta t'i implikojmë. Prandaj edhe renditja e hapave është e gabuar dhe këtu do të kemi probleme. Do të kemi probleme edhe me tenderin nesër, ne kemi pasur këtë edhe para dy vitesh, edhe para tre vitesh sepse modeli hibrid i cili është ky ligj nuk i garanton fituesit të tenderit së pari funksionalizim pasi që vetë përmbajtja e tij është gati në kadencë. Ne e dimë se dy mediat nacionale kanë të garantuar bartjen e obligueshme deri në vitin 2019 kur skadon licenca dhe pastaj ky ligj është i skaduar. Ne kemi ardhur afër skadimit të disa afateve të këtij ligji. Jemi në vitin 2017. Ky kur është propozuar ka qenë viti 2014, nëse nuk gaboje.

Dhe është shkuar kundër logjikës së natyrshme të tranzicionit, në të gjitha apo në shumicën e vendeve evropiane mediat ekzistuese janë digjitalizuar të parat. Ne hapin e parë është dashur Radiotelevizioni i Kosovës ta bëjë digjitalizimin. Gjithkund në Evropë është mediumi publik ai i cili e mban primatin e transformimit dhe hapin e parë e bën digjitalizimin, pasi që është ai

garanti minimal i një transparence ndaj publikut dhe ndaj një informacioni të hapur. Pra, u garanton qytetarëve të Republikës së Kosovës një informacion.

Së dyti, ky ligj nuk i ka adresuar qartë kërkesën tonë, të industrisë që konform të gjitha vendeve tjera të Bashkimit Evropian të ketë një multipleks të hapur, të garantohet që qytetari i Kosovës falas do të ketë mundësi që të shikojë programe të mediave edhe publike, edhe atyre që kanë mision publik, janë komerciale por që kanë program që janë të kualifikuara si media me bartje të obligueshme, pra ka një skemë programore e cila garanton një mision publik, informacione, lajme, debate. Ka munguar në këtë ligj, nuk është futur.

Problemi tjetër shumë më i madh ka qenë që e ceku edhe Ardita, direktivat evropiane në këtë ligj kanë qenë vetëm selektive në propozimin që ka ardhur prej Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, kanë qenë selektive, duke pasur parasysh se kanë menduar të fuzionohet me kohë me ligjin për komunikime elektronike dhe të implementohet nga ARKEP-i apo nga Ministria e zhvillimit ekonomik. Por, e dimë që kemi një rregullator të pavarur i cili është dashur që t'i ketë në një ligj të parapara rregullimin e tregut dhe analizën paraprake para çdo vendimi.

Ne kemi një para nismë, është një sfidë e madhe e ndryshimit të tregut medial në Kosovë. Dhe kemi frikën se nuk do të menaxhohet mirë, për arsye se infrastruktura ligjore nuk është e rregulluar mirë dhe nuk do të kemi mundësi ta parandalojmë monopolin, cilido qoftë ai, çfarëdo le të ketë emrin, por monopolin si mundësi nuk e kemi ndalë për shkak se nuk e kemi respektuar as Direktivën Evropiane. Ne e kemi cekur aty në një vend të ligjit mirëpo asnjë hap nuk është bërë në atë drejtim. Ne është dashur t'i kemi, të dimë se kush janë në tregun kryesor të mediave elektronike me transmetim tokësor, kush janë faktorët kryesorë, kush janë në tregjet tjera relevante dytësore, që janë në mediat kabllore, pra në rrjetat kabllore por edhe me IPTV por edhe me OTT, kush janë operatorët me fuqi të ndjeshme në Kosovë që e marrin tregun, e konsumojnë tregun medial dhe e marrin nga konsumatorët e Kosovës, qytetarët e Kosovës para. Cila është fuqia e tyre, ne nuk e dimë dhe të hysh në një tender pa e bërë një analizë të tillë paraprake kam frikën se do të përfundojë me monopol. Kaq, faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Hoti! Tani përfaqësuesi i Autoritetit të Rregullatorit të Komunikimeve Elektronike Postare, zoti Gashi.

KRESHNIK GASHI: Ju faleminderit shumë, i nderuar kryesues i takimit.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës të mediave,

Konsideroj se është shumë me rëndësi që Komisioni për Zhvillim Ekonomik, tregti dhe industri ka paraparë mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe në lidhje me këtë fillimisht sigurisht jeni njoftuar më parë që ka bërë një vizitë te të gjitha institucionet përgjegjëse që preken nga zbatimi

i këtij ligji dhe secili institucion përfshirë edhe ARKEP-in i kemi dhënë opinionet tona se deri ku ka ecur ligji dhe cilat janë shqetësimet tona dhe eventualisht si do të vazhdohet më tutje.

Si autoritet rregullativ i komunikimeve elektronike dhe postare për neve shqetësimi kryesor është që digjitalizimi nuk është arritur ende, sigurisht se ky shqetësim është edhe i gjithë tjerëve, por si pasojë e mosarritjes së digjitalizimit brezi që është në shfrytëzim për shërbime të radios dhe televizionit do të duhej të kalonte në brezin e shërbimeve radio-difuzive përkatësisht brezin 790 deri në 862 megahercë nuk mund të shfrytëzohet për shërbime të telefonisë kur dihet se ky brez është brezi më i përshtatshëm për shërbimet e telefonisë dhe është brezi më i kushtueshëm që do të mund të ndikonte pozitivisht edhe në rritjen e të hyrave për buxhetin e Kosovës. Për më tepër Bashkimi Evropian përveç që e parasheh në rekomandimet e tij si dhe institucionet përkatëse si “CEPT-i” dhe ... përveç që parashohin se ky brez duhet të përdoret për shërbimet e telefonisë ata parashohin që në një të ardhme të afërt, përkatësisht edhe brezi tjetër me direktivën ECC 11/04, ...694 deri 740 megaherc po ashtu të përdoret për shërbimet e telefonisë.

Do të thotë që, mos digjitalizimi ka pasur efekt të shumë anshëm sidomos në veprimtarinë e operatorëve që zhvillojnë veprime në fushën e komunikimeve elektronike. U tha me të drejtë që ky ligj është kompleks dhe i prek disa autoritete, përkatësisht sigurisht në implementimin e tij rolin kryesor e ka KPM-ja dhe udhëheqjen e ka KPM-ja, por preken edhe institucionet siç është ARKEP dhe MZHE. ARKEP-i është munduar që në vazhdimësi të luajë rolin e vetë në ofrimin e ekspertizës së nevojshme dhe pjesëmarrjes në takimet që janë ftuar nga komisioni i pavarur i mediave. E thashë për neve shqetësim kryesor është mos implementimi i ligjit si pasojë ndoshta edhe i kompleksitetit të tillë, por megjithatë vlen të përmendet sigurisht nga kolegët nga KPM-ja, janë përmend se janë përgatit një varg rregulloresh prej KPM-së, të cilat i paraprin procesit të digjitalizimit dhe e kemi thënë edhe at ditë para deputetëve që ne nuk jemi në një fazë ku duhet të ndalemi dhe të rishikojmë gjithçka se si të fillojmë edhe njëherë prej fillimi, por jemi në një fazë mjaftë të avancuar dhe besoj që duhet të vazhdohet më tutje me digjitalizim sa më shpejt që është e mundur për shkak se vonesat sigurisht na kanë shpjerë deri në një situatë të tillë që jemi pra para rajonit me digjitalizim.

Prej ARKEP-it ne kemi bashkëpunim të mirë me KPM-në, nuk mendoj që janë sugjerime të duhura dhe ato se në një draft të mëhershëm ministria ka paraparë diçka tjetër dhe tani parashihet diçka tjetër në ligj. Është e domosdoshme të kuptohet edhe kompleksiteti i institucioneve në të gjitha institucionet që Agjencitë e pavarura i kanë kompetencat e tyre që burojnë prej ligjit, disa përmenden në Kushtetutë, disa nuk përmenden, por ajo s’i bën as më të rëndësishme as më pak të rëndësishme. Shumicën e vendeve Autoriteti Rregullator i komunikimeve elektronike ka shumë rol të rëndësishëm në një proces të tillë, ne do të thotë legjislacioni jonë e ka paraparë një rol miks ku udhëheqjen e ka KPM-ja dhe ne jemi plotësisht të gatshëm të japim kontributin tonë në implementimin e plotë të Ligjit për digjitalizim.

Por, e ritheksoj se Autoritetin e Komunikimeve elektronike dhe postare si menaxhues i frekuencave në nivel shtetëror, mos largimi prej brezit 790 deri në 862 mega herc është duke shkaktuar humbje të mëdha të buxhetit të Kosovës dhe të operatorëve që operojnë në komunikimet elektronike dhe postare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gashi!

Tani kush e do fjalën tjetër? po duket se nuk ka të tjerë të interesuar. Atëherë do të bëjë përpjekje, a e do fjalën. Deputetet Blerim Grainca e do fjalën.

BLERIM GRAINCA: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, për kolegët.

Këto diskutimet publike janë pothuajse praktike të komisionit tonë, por edhe të Parlamentit edhe një ligj sikur ky mendoj se duhet të trajtohet kështu me seriozitet, por megjithatë mendoj se jemi vonë të gjithë, edhe ne si komision, edhe Kuvendi, institucionet tjera veçanërisht KPM-ja si bartëse kryesore e të gjithë projektit.

Më lejoni të them dy-tri gjëra për vetë kronologjinë e problemit të digjitalizimit. Fillimisht kur kemi punuar në hartimin e këtij ligji e dini shumica prej tyre që jemi rreth kësaj tavoline kanë qenë pjesë e Grupit për hartimin e ligjit. Edhe ligji që është para jush këtu, Ligji për digjitalizim, është ardhur si rezultat i harmonizimit të qëndrimeve që janë bërë në mes të gjithë akterëve plus minus me ndonjë vërejtje të vogël, me ndonjë lëshim, sepse Kuvendi s'mund t'i plotësojë dëshirat e të gjithëve mirëpo në parim ka pasur një harmonizim të qëndrimeve, afateve, autorizimeve dhe të gjithave që dalin nga ky ligj.

Tash jemi në një situatë kur mbas krejt kësaj që u tha, në bazë të atyre takimeve që kemi pas bashkë me Raifin, del se jemi vonë me Ligjin për digjitalizim. Dhe unë si deputet kam për obligim të konstatoj kështu qysh është gjendja reale sado që mundohemi me kamufluar ndonjëherë, me fol me një gjuhë politike, por e vërteta është se procesi i digjitalizimit në këtë moment për mua personalisht deri këtu ku është, është i dështuar. Unë e shoh kështu, ndoshta e kam gabim nuk dua të hy në çështje teknike, por në kuptimin e afateve kohore. Tash nëse duam të luajmë ping-pong edhe me ia gju fajin në mes kush është fajtor a është Qeveria s'i ka fondet, a është Kuvendi që s'i ka mbikëqyrë mirë, a është KPM-ja që s'e ka kryer punën sa duhet, cili ka mundur të jetë roli edhe i ARKEP-it apo edhe i vetë industrisë është çështje tjetër. mendoj që sot nuk duhet të provojmë ta gjejmë at faktorin apo ta shpallim dikë fajtor kujdestar, por duhet ta gjejmë daljen nga kjo situatë.

A ka, unë po e shoh prej juve se jeni profesionalisht të thirrur për këtë punë, po e shtroj si pyetje a ka hapësirë edhe ligjore edhe teknike që kjo punë të kryhet më shpejt? Po flas me procesin e tenderimit, nëse bëjmë tenderin a do të jetë profesional a do t'i mundësojë të gjithë akterëve garë të barabartë dhe a do të sigurojë një barazi në industrinë e mediave. Për arsye se ne si grup punues duhet të japim një përgjigje për këtë punë, a ka dështuar përfundimisht procesi, a ka

shpresë që të kryhet edhe çka duhet të bëjmë që me u mobilizuar të gjithë akterët që jemi këtu që edhe Komisioni i Pavarur i Mediave, që në fund të fundit i raporton Kuvendit, me dal i suksesshëm prej këtij procesi. Sepse, nëse fillojmë me akuzuar njëri-tjetrin dhe me gjet arsye për dështim mendoj se nuk na qon kurrkund, gjithsesi me fol në atë gjuhën e doktorëve ne s'mundemi ta shërojmë problemin, as s'mundemi ta shërojmë sëmundjen pa e diagnostifikuar.

Diagnoza është e saktë, ne kemi dështuar deri tash hajde çka po bëjmë tutje. Mendoj se si Kuvend kemi për obligim të kërkojmë përgjigje edhe kryesuesi i grupit është këtu, kështu që unë e kam si pyetje a mundemi me dal për të konkretizuar, a mundemi me dal prej kësaj situate?

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Urdhëroni zoti Krasniqi.

XHEMAJL KRASNIQI: Është e vërtetë që ne jemi vonuar, nuk ka dilema këtu që jemi vonuar edhe këtu nuk është vetëm një fajtor, absolut, por në fazën, në momentin që jemi unë mendoj se ky proces mund të shtyhet. Ndiham duhet me qenë e gjithanshme, nuk duhet askush në këtë sallë ose prej akterëve që do të involvohen në këtë proces me e ndje veten komod edhe tash urdhëroni komisioni i pavarur, urdhëroni ARKEP-i, urdhëroni ministria. Të gjithë që kanë forcë dhe vullnet që të involvohen në këtë proces është me të vërtetë ka vend, ka hapësirë për të ndihmuar.

Është proces i madh, është kafshatë e madhe kjo për një komision prej 30 vetëve që ta menaxhojë këtë proces i cili në rastet më të lira, ka kushtuar me dhjetëra miliona euro. Kështu që ky proces ka hapësirë për çdokënd. Unë gjithmonë kam ftuar institucionet e shtetit, urdhëroni ndihmonani në këtë proces, sepse nuk e konsideroj si ndërhyrje në punën e komisionit në qoftë se ju na ndihmoni në një proces të rëndësishëm për t'i lëvizur punët përpara.

Zonja Izmaku, sigurisht disa herë mua më ka dëgjuar së paku në deklaratën time publike që e kam bërë rreth kësaj. Tash procesi i shpalljes së tenderit ajo është vetëm fillimi i problemit, çështja e një rregulloreje që përmendi zonja nga AMPEK-u ajo është një punë e cila ok, Komisioni i Pavarur e paska bërë një lëshim ajo është punë që korrigjohet, që domethënë një rregullore të tillë mund të miratohet dhe nuk është ndonjë pengesë e madhe. Por, pengesat janë tjera domethënë mungesa e parave, ne s'kemi pasur mjete që t'i paguajmë njerëzit për shembull një rrugë me shku me pa, një shtet qysh e ka realizuar mandej edhe implementimi i përvojave nga shtetet e tjera vjen ndryshe-ndryshe, plot shtete si për shembull: Maqedonia, Sllovenia kanë implelementuar njëherë një proces të digjitalizimit, pastaj janë kthyer edhe njëherë prej fillimit e kanë implelementuar për së dyti se kanë qenë të pakënaqur.

Mos involvimi i fondeve të IPA-së, ajo është nuk është që ne s'jemi kujtuar që të involvojmë fondet e IPA-së, por në komunikim me Komisionin Evropian, me Qeverinë, IPA financon në institucionet publike. Ne konceptin e kemi pasur asisoj që Qeveria ka thënë "s'japim fonde" ne jemi orientuar kah angazhimi i partnerëve privat, po pakot tenderuese komerciale që absolut

menjëherë e eliminon mundësinë e involvimit të fondeve të IPA-së. RTK-ja pse nuk është involvuar, se nuk ka kërkuar RTK-ja fonde të IPA-së. As nuk është e imja as nuk di të them pse.

Kështu që mandej problemet e mëdha që janë të rëndësishme ne që kemi, ne kemi një grusht sa grima frekuenca të pamjaftueshme për me ekzekutuar, ne kemi harxhuar alamet energji në gjetjen e zgjidhjes, riorganizimin e frekuencave në mënyrë që me krijuar një mundësi, një hapësirë që me i pas dy frekuenca të lira për të shpall një tender në mënyrë që me u lirua pastaj frekuencat analoge aktualisht që janë në transmetim për me i shpall masandej në grupin tjetër edhe tri frekuenca të tjera të cilat lirohen.

Kurrkush nuk na ka qajt neve hallin si 40% të frekuencave të mundshme të cilat ishte dashur me qenë pjesë të territorit të Kosovës na nuk i menaxhojmë. Edhe qito bile i kemi pak si kontestuese, po hajde qito diqysh pak me përkrahjen e Unionit Evropian, e kemi marrë pak si në dorë punën edhe s'po e pyesim askënd dhe ... mendoj këto janë probleme me të cilat me të vërtetë unë e konsideroj që duhet komplet shteti me u involvuar në këtë proces. Më falni se unë merrem me këtë problem që viti i 6 dhe pak po bëhem nervoz pse bash nuk më ka ec puna mirë në këtë punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi! Deputetja Izmaku, urdhëroni e keni fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Unë e çmoj këtë sinqeritetin që e tha zoti Krasniqi, e tregoi krejt po kisha dashur direkt pyetje: ju keni takime shumë edhe përfaqësoni jashtëzakonisht jashtë vendit kryesisht ju personalisht, por anëtarët e komisionit, a keni kërkuar këtë përkrahje ndonjëherë në ndonjë organizatë ndërkombëtare asociacion, gjatë konferencave të ndryshme me na përkrahë neve që me e fitu ne këtë të drejtë, për të menaxhuar 40%, sepse realisht si deputetë është bërë domethënë disa herë por ndryshe është kur ju jeni kategori kushtetuese dhe e njihni profesionalisht këtë punë.

Ku e keni adresuar kishim pas qef ta dimë, sepse vetë ne nuk po mundemi t'i përdorim këto frekuenca është fatkeqësi nuk arrijmë t'i përdorim, ku i keni adresuar. Nëse ka mundësi qoftë edhe krye shfja kur flet, por është me rëndësi me dit edhe anëtarët këtu, sepse shpeshherë e shohim që përfaqëson KPM-ja por është mirë me e ditë nëse adresohen këto çështje apo nuk adreson. Faleminderit!

XHEMAJL KRASNIQI: Zyrtarisht neve nuk e kemi kërkuar në institucionet e shtetit tonë këtë çështje por e kemi shtruar kështu nëpër diskutime publike, ne jse unë s'e di më falni ndoshta para se me ardhur unë aty në komision, korrigjimi është i mirë se ardhur.

Në institucionet ndërkombëtare ne nuk kemi mundur, sepse institucioni relevant që e menaxhon këtë punë është IPU aty neve s'na lënë me hy te dera. Kush mundet të hyjë aty? Mundet

ARKEP-i, mundet Qeveria, ne s'kemi pasur mundësi edhe pse ne jemi institucion kushtetues por neve nuk na kanë lënë që t'i qasemi. Ka pas përpjekje për me iu qas ITU-së para se me qenë unë anëtarë i komisionit, por me të vërtetë unë këtë nuk e di tash besoj Nailja na informon pak më shumë.

NAILE KRASNIQI: Përshëndetje për të gjithë,

I nderuar kryesues zoti Qela,

E nderuar zonja Izmaku,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve të ndryshme dhe mediave që jeni prezent. Nuk po di a të filloj tash me këtë përgjigjen për ITU-në, jemi duke fol për një proces të vonuar edhe është diçka shumë e qartë për vetë faktin se Ligji për digjitalizimin ka hy në fuqi mas një afati që është përcaktuar për qershorin e vitit 2015.

Vonesat na kanë ndjek që nga fillimi dhe me bazën ligjore, dhe problemet që kemi pas me strategjinë ku ne kemi dërguar në mars të vitit 2015, një strategji e cila është përgatit domethënë pas një faze goxha të gjatë edhe pune edhe konsultime me të gjithë akterët edhe duke tentuar të marrim parasysh të gjitha praktikat më të mira, dhe që fatkeqësisht disa muaj pasi është dërguar ajo strategji në qeveri ne kemi marrë kërkesë të prezantojmë vlerësimin e ndikimit buxhetor, do të thotë nga vetë zyra për planifikim strategjik që fatkeqësisht ai vlerësim nga Ministria e Financave është bërë domethënë, ka qenë një opinion negativ dhe është thënë që nuk ka planifikime do të thotë për këtë çështje dhe mandej një vlerësim i zyrës për planifikim strategjik që ndërlidhet me miratim të strategjisë së KPM-së ka qenë që ne duhet ta kemi parasysh këtë opinion. Do të thotë nuk ka mjete dhe mandej ne duhet vetëm ta kemi parasysh dhe domethënë në fakt nuk ndodh asgjë.

Çka kemi tentuar prapë pas miratimit të ligjit që u cek paraprakisht kemi tentuar dhe kemi arrit të bëjmë me vonesa ato obligimet që na janë vënë për çka edhe ne nuk mund të jemi plotësisht të kënaqur. Për të filluar tash të ju përgjigjem pyetjeve ose çështjeve domethënë si bashkëbisedim që u ngritën këtu, po filloj me çështjen që e ngriti zonja Izmaku në relacion me ITU-në.

Zoti Krasniqi ka qenë, domethënë është në përbërje më të vonshme të komisioneve ku ne do të thotë në vitin 2006 është krijuar edhe Institucioni i KPM-së, në vitin 2006 ka ndodh edhe konferenca regjionale do të thotë që njihet si konferenca e ITU-së ku janë përcaktuar planet digjitale frekuencore për transmetim tokësor.

Unë personalisht kam bërë komunikim zyrtar edhe me Qeverinë të Republikës së Kosovës dhe komunikim me ITU-në, edhe pse nuk jemi anëtarë domethënë kemi pas të drejtë të kërkojmë pse Kosova ka qenë e përjashtuar nga ato planifikimet paraprake dhe kemi paralajmëruar dhe kemi ngrit shqetësimin tonë që atëherë edhe me institucionet vendore e ato ndërkombëtare që Kosova do të jetë si një pikë e zezë në gjithë këtë zhvillim teknologjik dhe në transmetimet e të ardhmes digjitale.

Fatkeqësisht kanë ardhur përgjigjet do të thotë duke u bazuar në çështjet e statusit të Kosovës që jo nuk është anëtare e ITU-së dhe domethënë është diçka që nuk mund të bëhet ndonjë ndryshim ose çfarëdo qoftë. Edhe kjo po vazhdon edhe tani edhe në këtë moment, fatkeqësisht edhe në iniciativa në nivele më të ulëta çfarëdo qofshin ato për shkak të mos anëtarësimit të Kosovës edhe në ITU dhe në organizmat tjerë ndërkombëtar, ne po besim të përjashtuar. Kjo ka qenë një problem, vazhdon të jetë problem sidoqoftë ne jemi bazuar në atë planë që është përcaktuar për Kosovën, kemi bërë një riplanifikim, kemi bërë analiza do të thotë që nga viti 2008 për të prezantuar si nocion vetë digjitalizimin me treguar që është diçka që është e pashmangshme, nuk është diçka që ne po e zgjedhim, por do të imponohet. Kemi filluar një hartim të një strategjie dhe kemi shpresuar që vetëm strategjia sikurse në të gjitha vendet domethënë të zhvilluara edhe në ... regjionit do të jetë dokumenti bazë për të hap rrugën drejt digjitalizimi. Në ndërkohë patëm ndryshim të Ligjit për KPM-në ku përcaktuam pastaj të ketë edhe ligj, dhe mandej do të thotë gjithçka shkoi në një rrugë jo domethënë të mirë të koordinuar u miratua një ligj jo shumë i harmonizuar me strategjinë dhe ky mos harmonizim sidomos është brengosës për KPM-në për faktin që televizionet regjionale lokale mbesin jashtë këtij ligji, mirëpo KPM-ja do të vazhdojë do të thotë synimet e veta dhe planet e veta domethënë gjithsesi që edhe televizionet e nivelit regjionale lokale të organizohen në ... sikurse ju kemi dhënë mundësinë me strategjinë dhe të jenë pjesë e digjitalizimit.

Problemi kryesor do të thotë edhe tash gjatë këtyre fazave të vonshme ku ne jemi duke punuar në materialin tenderues, por edhe më herët që është identifikuar është çështje domethënë e funksionimit ose organizimeve që janë bërë pasluftës në Kosovë e sidomos është problem çështja e rrjetës. Kjo ndërlidh mandej edhe problemin për fondet IPA, kemi diskutuar më herët por për faktin që nuk kemi pas një identitet publik ose një rrjet publik është menduar që nëse fillohet domethënë tani të krijohet një diçka kësaj duhet të krijohen organizma të ri dhe njëfarë forme kjo është problem se ndoshta është dashur gjithsesi edhe KPM-ja edhe akterët tjerë të jenë më këmbëngulës dhe të arrijmë diçka për të siguruar që edhe Kosova ta ketë një rrjet publik, sepse kjo gjithsesi kishte për ta lehtësuar domethënë tërë procesin përballë të cilit jemi tani edhe do të thotë kish me ndoshta shumë dilema ose frika edhe të vetë industrisë domethënë që duhet të jenë pjesë e këtij procesi, të mos mbesin më çështje sepse edhe në aspektin e kostos do të ishte më i lehtë ngase tani me Ligjin për digjitalizim, por edhe me procesin që ne duhet ta përcjellim edhe me pakon tenderuese do të thotë që do të bazohet tërësisht në atë që ka përcaktuar Ligji për digjitalizim dhe në aspektet tjera, praktikatat tjera që po mundohen të marrim më të mira për procesin.

Domethënë, na ka mbet që do të kenë një transmetues publik me një multipleks nuk është definuar çështja se kush do ta menaxhojë, se çfarë rrjeti do të funksionojnë transmetuesi publik dhe ka mbet tërësisht, do të thotë çështja e ... komercial, çështje komerciale dhe kushdo që e fiton at tender domethënë duhet të investojë, për atë edhe Ligji për digjitalizim nuk ka pasur kosto

financiare të atillë. Çështjen e analizës së tregut ose një studim fizibiliteti që për çdo gjë është shumë i nevojshëm fatkeqësisht do të thotë KPM-ja nuk ka arrit ta realizojë për shkaqet që u cekën më herët, domethënë që lidhen me buxhetin edhe me problemet domethënë që lidhen me ato kërkesat tona të vazhdueshme po që nuk kanë hasur në ndonjë përgjigje pozitive, ndoshta është menduar keq që ky është vetëm një punë e KPM-së dhe nuk është menduar që me të vërtetë është një projekt i rëndësishëm nacional që i prek të gjithë, edhe kryesorja që e prek qytetarin.

Ne e kemi promovuar domethënë jo vetëm pse kemi dashur, por pse është i atillë që nga fillimi digjitalizimin me përfitim shumë të madh që do t'i sjell publikut kosovar më shumë mundësi, sinjal, pamje, mundësi më të mirë gjithsesi KPM duhet ta ketë parasysh edhe në atë çështjen që e ceku zoti Hoti, për një ... të hapur. Ne gjithsesi duhet të sigurohemi do të thotë që në ato ndarjet e kapaciteteve t'i sigurojmë publikut kosovar që të ketë kanale të mjaftueshme do të thotë që informojnë për atë çka ndodh në Kosovë, po edhe mundësitë tjera që duhet të ofrohen për shkak të çështjeve komerciale që ndërlidhen me ato aspektet e menaxhimit të ... Do të thotë, problemet e buxhetit që ndoshta për shumë kënd mund të mos jenë të rëndësishme ose domethënë si kyçe na sjellin ... sfida që ne i shohim për të ardhmen, është çështja do të thotë analizat na kanë munguar dhe po na mungojnë vazhdimisht që ne domethënë si rregullator të kemi baza vjetore analizë të tregut, sepse kjo do t'i ndihmonte edhe KPM-së domethënë që edhe politikat e veta transmetimit t'i adresojë në atë formë që me ju përshtat gjendjes që ne e shohim, sidomos do të ishte e nevojshme edhe për vetë mediat të shohin gjendjen, do të thotë të kuptojnë edhe këta faktorët që janë me fuqi të ndjeshme, edhe të sigurohemi që me çfarëdo procesi ne as nuk krijojmë monopol, as nuk është domethënë që krijojmë telashe dhe e shpartallojmë një situatë që është e krijuar në fushën mediale.

Për çështjen e rregullores së pronësisë kur KPM-ja ka përgatit strategjinë për digjitalizim kemi pas një plan veprimi me një numër rregulloresh, të cilat i kemi planifikuar para se të miratohej edhe ligji. Një ndër to është edhe Rregullorja për pronësinë dhe KPM-ja e ka një draft të parë të asaj Rregulloreje dhe në Kosovë kemi një situatë që në mungesë të Rregullores për pronësinë në vitet e kaluara kemi një gjendje që një entitet juridik ka disa domethënë një numër të caktuar mediumesh edhe kjo është diçka që ne si KPM duhet të sigurohemi që me këtë rregullore e gjejmë modelin më të mirë me rregullu, do të thotë që të sigurohemi që mos të kemi koncentrim të medias, por edhe mos të shkaktojmë do të thotë probleme të mëdha në atë gjendjen aktuale që është, kjo është ajo çka mundem me thënë.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Krasniqi.

Ka dikush tjetër, po zoti Hoti.

VISAR HOTI: Janë të domosdoshme amendamentimi i ligjit, edhe pse duket vonë por më mirë është që menjëherë të futemi në veprim dhe të amendamentojmë ligjin dhe ta sjellim në domenin

real të realizimit dhe të mos kemi ide abstrakte për një digjitalizim i cili do të ishte i panatyrshëm në relacion me proceset në vendet tjera.

Së pari, ky ligj nuk e garanton diversitetin dhe pluralizmin tek operatorët e transmetimit.

Nga rrafshi analog kemi pasur diku afër 20 e diçka operatorë dhe përnjëherësh po strukemi që të sjellim dhe një operator, kështu ishte edhe drafti i parë i ligjit të paraparë. Pra, nuk kemi garanci të një konkurrence të shëndoshë, nëse vetëm fokusohemi në pjesën e platformës, në atë pjesën e dytë, po nuk kemi garanci të pjesës së parë, asaj bazikes, shtresës së parë që është operatori që shfrytëzon resursin frekuencor. RTK-në që e kemi të garantuar me ligj si operator e fusim prapa diku, pasi ta bëjmë këtë shitjen në komerciale, që është hap i panatyrshëm, gjithashtu.

Po ashtu, u përmend në mediet rajonale edhe lokale që janë në mënyrë implicite diku përmenden në ligj e në gjërat eksplicite në ligj nuk po i implementojmë e lëre më ato implicite, që i harrojmë krejt, që sipas rekomandimeve të Bashkimit Evropian në direktivën për komunikimet elektronike, po ashtu edhe në direktivën edhe në udhëzuesit e ITU-së digjitalizimi duhet të jetë proces paralel dhe gjithëpërfshirës. Po mos të jetë kështu kemi avantazhin e parë, operatori i parë që del në digjitalizim ai edhe ka avantazhin e tregut.

Këtu është problemi kyç që ne duhet ta zgjidhim me ndryshimin e ligjit, një. E dyta, rrjedha normale është që Radiotelevizioni i Kosovës duhet të jetë prijës i digjitalizimit. Mediet komerciale ekzistuese duhet t'u gjendet qarja, në vendet tjera ato vetë e kanë bërë digjitalizimit, këto duhet të digjitalizohen edhe duhet të zgjidhet problemi i tyre edhe në nivel të Kosovës edhe në atë rajonal dhe lokal. Në momentin që kryhet kjo detyrë e shtëpisë, pra përkujdesemi së pari për familjen pastaj dalim te fqinjët dhe te pjesa komerciale, ku operatori komercial pastaj e ka fotografinë e qartë të tregut, se me çfarë oferte do të shkojë dhe me çfarë oferte do të dalë.

Nuk kemi pasur asnjë model ekonomik që na e ka precizuar të kundërtën, se pikërisht ky model nuk kemi pasur asnjë shifër, asnjë numër, as në komisione, as ju si deputetë nuk e keni pasur, as publiku i Kosovës nuk e ka pasur një transparencë të qartë se pse ky model, i cili vetëm është kah na zhagitë dhe është kah shkon kah skadimi. Po ju garantoj, se nëse shkon edhe pak kohë, që komerciali ose tenderuese a fituesi i tenderit, ose aplikuesi për tender, nuk do të jetë i interesuar nëse nuk i ka mediet e Kosovës në pako, sepse ligjërisht afati i tyre po kalon. Licencat duhet të ripërtërihen në vitin 2019, është edhe dy vjet.

Prandaj, këto ndryshimet ligjore sa më herët që të bëhen kthehemi në kursin normal të kalimit nga transmetimi analog në digjital dhe shumë shpejt do të jemi një Kosovë, e cila është në përputhje me rrjedhat evropiane për transmetime digjitale. RTK-ja, natyrisht, është e para që do të kishte mundur t'i shfrytëzojë fondet IPA dhe kjo ndoshta duhet t'i bëhet presion këtij mediumi, por edhe KPM-së e edhe juve si deputetë, ta merrni përsipër që të trokasim nëpër

dyert, kur Serbia e Mali i Zi e kanë kryer këtë proces me paratë e evropiane, pse Kosova nuk mundet kur është shumë më e vogël, kur kostoja është shumë më e vogël.

Pastaj edhe te kostoja, ne nuk kemi... kostot e paraqitura në strategji janë tashmë të skaduara. Janë bërë llogaritje në vitin 2014 a 2015, teknologjia ka ecur përpara. Ne mundemi. Ndoshta, nuk është edhe resursi frekuencor që po na mungon tash, është gjithsesi i dëshirueshëm, por nuk është pengesa për ta realizuar digjitalizimin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti. Urdhëroni, zoti Krasniqi, edhe një herë, por sa më shkurt.

XHEMAJL KRASNIQI: Shumë shkurt. Rruga që është përshkruar afërsisht në ligj, me gjithë këto mungesa evidente, ne i kemi bërë edhe vërejtjet tona, besoj që ju kanë ardhur.

Mendoj se është rruga më e mirë e mundshme me e shty procesin përpara. Shpallja e tenderit komercial dhe futja në jetë e tenderit komercial sa më përpara është çelësi i zgjidhjes së problemit. Ne i kemi ofruar RTK-së zgjidhje, që ata mund ta fillojnë procesin e digjitalizimit me një brez frekuencor, i cili nuk është shumë i popullarizuar, mirëpo ne këtë mundësi kemi. këto dy frekuenca i kemi në lojë dhe s'kemi tjetër mundësi. RTK-ja po të donte të lëvizte, ka mundësi dhe mund të gjenden modelet, kur për Kosovën ekzekutimi më i mirë është ndihma që të ekzekutohet procesi i tenderimit, të bëhet zgjedhja e operatorit të mundshëm.

Kolegu i AMPEK-ut, që po ankohet për skadimin e licencave, këto janë gjëra për të cilat ligjet kanë karakter dinamik, Kuvendi është nons-top në punë, Komisioni i Pavarur i Medieve është non-stop në punë dhe mundet konform kërkesave dhe sfidave që na dalin përpara ta përshtat ligjin, ta përshtat rregulloren, kjo nuk mendoj unë që është problem. Ndërsa, ajo që është më e frikshme për mua, vetë digjitalizimi, që e përmendi kolegu, modeli i Shqipërisë është i tmerrshëm.

Unë nuk i kisha dashur këtij vendi ta zbatojë modelin e digjitalizimit që e ka zbatuar Shqipëria, domethënë nuk e ka zbatuar por është në fillet e digjitalizimit brenda shtetit. Pse? Me e marrë ti ligjin në dorë dhe me e zgjidhë këtë për vullnetin tënd a? Ajo është e papranueshme për secilin vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Përafërsisht, jam i njoftuar me modelin që është shfrytëzuar në Republikën e Shqipërisë, për shkak se është vonuar me zbatim të ligjit, për shkak se është vonuar me tërë procesin. Mediet e fuqishme e kanë marrë situatën në dorë në mënyrë të kundërligjshme dhe e kanë detyruar, e kanë prurë gati se rregullatorin para aktit të kryer. Por, kjo nuk do të ndodhë tek ne.

E deshët fjalën? Deputetja Pantina.

SHQIPE PANTINA: Kërkoj falje! Unë kam ardhur me vonesë, për shkak se komisioni tjetër kishte mbledhje.

Unë më shumë kam pyetje, që janë shqetësime në fakt, sepse nuk isha këtu gjatë tërë kohës dhe kërkoj falje, po që se tashmë në disa prej këtyre çështjeve është dhënë përgjigja.

Nuk di sa është hapësira për t'u rishqyrtuar edhe një herë strategjia, sepse është e pakuptimtë që strategjia ende të mos miratohet, strategjia për digjitalizim. Po, ka mundësi që tashmë asaj si e tillë, si dokument e tillë mund të jetë i vjetëruar dhe duhet rishikuar edhe një herë dhe nuk di çfarë është duke bërë KPM-ja në rishqyrtimin e kësaj strategjie, sepse nuk besoj se tash duhet pritur a po e kalon a jo Qeveria e në momentin kur kalon, nëse kalon si e tillë, nuk është më as e përdorueshme, nuk është më as e dobishme. Kështu që, ndoshta KPM-ja duhet të jetë më proaktive, të fillojë ta rihartojë strategjinë dhe t'ia dërgojë edhe një herë një version tjetër. Nëse tashmë e keni diskutuar, kërkoj falje, mund të më thoni po e keni bërë ose jo.

Çështja tjetër, në fakt unë nuk besoj se duhet të jepet përparësi televizioneve private komerciale, përkundër faktit se ne jemi për llojllojshmëri dhe jemi për të pasur, se unë personalisht po edhe lëvizja, jemi për të pasur medie sa më shumë, por ne duhet ta ruajmë televizionin publik, ashtu siç është, me shumë probleme. Tash, fakti që ai ka probleme në menaxhim, ne nuk duhet ta dëmtojmë institucionin. Prandaj, unë pajtohem me Visarin, kur thotë se megjithatë RTK-ja duhet të jetë prijëse e... nëse nuk ka sistem ku të gjithë, me kushte të barabarta, e fillojnë startin barabartë, RTK-ja nuk duhet në asnjë moment të dëmtohet për çfarëdo lloj... edhe nëse ata janë vonë, sepse është përgjegjësi e jona megjithatë. Nëse ata janë vonë, domethënë se është edhe përgjegjësi e jona.

Çështja tjetër për komisionin, po më duket se edhe ligji tashmë nuk është i dobishëm. Nuk e di a do të ketë nevojë, e para, për ta rishqyrtuar, sepse nuk është siç po thotë zotëria, Kuvendi kaq dinamik dhe e kalon shpejt. Ne e dimë sa janë procedurat e rregullta për ta kaluar një projektligj. Nuk mundemi brenda çdo muaji të kalojmë ligj. Natyrisht, që çdo ligj kur të bëhet e ka një vizion se çka do të arrihet, jo vetëm në situatën aktuale, por çka do të ndodhë në të ardhmen. Kështu që nuk e di... prapë po them, janë dilema, janë pyetje, se jemi shumë vonë me proces. Nuk di sa po humbim, ndoshta nuk po humbasim shumë, por megjithatë jemi vonë dhe çdo vonesë edhe fakti që ne kemi bërë një ligj dhe kemi dashur të bëjmë një proces, disa humbje i kemi. tash, kush do t'i pësojë ato humbje, ndoshta janë vetë mediet që kanë me pas humbje. S'e di sa qytetarët, s'e di sa shteti, por dikush në këtë proces të vonuar po humb, e në anën tjetër, dikush duhet të japë llogari pse e ka vonuar këtë proces dhe i ka shkaktuar humbjet, qoftë mediet, në këtë rast po i shoh edhe si biznese, qoftë publikut, por nuk mundemi tash kështu, hajt, u vonuam, por faji është jetim... i kurrkujt... duhet kërkuar fajtorin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Urdhëroni, zoti Krasniqi!

XHEMAJL KRASNIQI: Kur mendova, nuk duhet me qenë pengesë çështja e skadimit të licencës, unë mendova në licencë, në diçka që rregullohet me Rregulloren e KPM-së e jo me Ligjin, prandaj unë nuk e shoh atë problem. Pastaj, e zgjerova pak më shumë... thash se ligjet janë me të vërtetë kategori dinamike, se ato u përgjigjen sfidave që i sjellë koha. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, zoti Hoti.

VISAR HOTI: Pak më herët harrova të përmend edhe çështjen e ... ne patëm propozuar në... si industri që të futet një nen i veçantë në Ligjin për transmetime digjitale, ai i analizës paraprake të tregut, i cili nuk gjeti përkrahjen e juaj. Mendojmë se prapë është i domosdoshëm, pasi që është direktivë evropiane. Rregullatori tjetër që rregullon komunikimet elektronike e ka dhe në mënyrë obligative i poston gjendjen e tregut dhe ndërmarrjet me fuqi të ndjeshme në treg dhe para çdo vendimi bëhet një analizë e tillë. mendoj, se edhe KPM-ja e ka për detyrë dhe obligim që paralelisht, para se të ndërmerret një hap i tillë, siç është dalja me tender, duhet të bëhet paraprakisht analiza paraprake dhe të krijohen mekanizmat mbrojtës nga monopoli.

Ky është qëllimi i këtij neni, ky është qëllimi edhe i vet direktivës evropiane, për të siguruar pluralizmin dhe diversitetin e medieve dhe për të parandaluar monopolin në treg. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti. Tani po përpiqem ta përmbyll. Megjithatë e keni fjalën zonja Krasniqi.

NAILE KRASNIQI: Zonja Pantina e kishte një pyetje.

Unë vetëm desha të them, që në fund të vitit të kaluar është kërkuar nga Zyra për Planifikim Strategjik, që teksti i strategjisë të sillet në një format, siç është përcaktuar me një udhëzim administrativ, kështu që KPM-ja domethënë duhet ta sjellë, por në përbërje ose të shkojë prapë në një rishqyrtim nuk e mendojmë të nevojshme, sepse në strategji kemi paraparë edhe proces të digjitalizimit dhe pas këtij transmetimit fillestar në digjitalizim komerciale dhe RTK-në. Për ne është shumë me rëndësi që strategjia të miratohet, të mos ketë vonesa në të, pikërisht për të vazhduar digjitalizimin me televizionet regjionale dhe lokale.

Kështu që, ai rishikim që duhet ta bëjmë do të jetë më tepër teknik. Gjërat që veç i kemi bërë, rregulloret dhe obligimet tjera të largohen, por nuk mendohet një proces i ri dhe prapë të mendohet gjithçka, se nuk ka nevojë. Do të thotë, atë tekst që e kemi dorëzuar në Qeveri ka qenë tekst i përpiluar pas një pune përmes grupeve punuese, ku kanë qenë të përfshirë të gjithë aktorët dhe nuk e kemi të nevojshme që prapë të shkaktojmë një vonesë ose diçka tjetër, që do të jetë edhe më problem.

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëroni!

LUAN LATIFI: Faleminderit, kryesues!

Jam Luan Latifi, drejtor i departamentit të Licencimit në Komisionin e Pavarur për medie.

Vetëm desha meqë jemi në fund me gjasë, të flas shkurt për pakon tenderuese. U përmend puna e KPM-së me vërejtje, pa vërejtje, me përparësi, me mangësi, me probleme buxhetore. u tha edhe më herët, jemi në fazën përfundimtare të hartimit të pakos tenderuese. Ashtu, siç jemi zotuar edhe në takimin që patëm me ju, zoti kryesues, besoj se qershori do të jetë afati i fundit për t'u publikuar, për t'u shpallë publike pakoja tenderuese. Mirëpo, u përmend monopoli, llojllojshmëria, kjo mund të garantojmë se nuk ka të bëjë me monopol, janë evituar të gjitha, janë marrë parasysh të gjitha këto vërejtje. Në momentin që kemi dy frekuenca për tenderë nuk bëhet fjalë për monopol. Shumëllojshmëria mediale MUKS-i me teknologjinë e re, me single technology network është pjesë e teknikës, ofron mundësi të mëdha të programeve, kështu që nuk bëhet fjalë edhe për monopol, qoftë në kuptimin përmbajtjesor, qoftë në kuptimin e menaxhimit me multiplex e me rrjet. Problemet me rrjet e problemet ndërkombëtare që i kemi në raport me mekanizmat ndërkombëtarë, u përmendën më herët. Kështu që, me të gjitha vështirësitë, përveç vonesës që e pranuan të gjithë se jemi vonë, dështim nuk kemi. nuk mund të flasim për dështim, meqë s'kemi filluar akoma.

Kështu që në qershor besoj se do ta mbajmë zotimin dhe gjithçka është gati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë, Hoti, por përpikuni të mos e zgjasni. Mirë, le ta ketë fjalën. Urdhëroni!

ENVER BASHA: Faleminderit!

Po e ndjej të nevojshme ta ripërsëris atë që e thamë edhe më herët. Ne mendojmë, se ligji është i zbatueshëm, përkundër vonesave të deritashme ligjit duhet të zbatohet. Nuk ka zgjedhje aty a duhet të amendamentohet apo jo. pengesë nuk duhet të jetë strategjia, sepse ligji nuk e kërkon patjetër strategjinë, atë duhet normalisht të bazohet në politika strategjike, por edhe të pamiratuara. Ligji mund të funksionojë.

Sa i përket konkurrencës, mendojmë se nuk ka rrezik të monopolit, për shkak se falë zgjedhjeve teknologjike transmetimet me kabllovik janë më të përhapura dhe nuk ka kurrfarë rreziku që mund të ketë monopol në këtë drejtim.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani po përpikem ta përmbyll. Zoti Hoti, më falni, urdhëroni!

VISAR HOTI: Ndoshta do të ishte mirë me e marrë mendimin e Agjencisë për Mbrojtjen e Konkurrencës për çështjen e para se të shkohet në pakon tenderuese, të merret një mendim i tyre

pasi që edhe ata janë një institucion në ngritje e sipër Agjencia për Mbrojtjen e Konkurrencës, para se të shkohet në... ta bëjnë ata interpretimin e direktivës evropiane të këtij ligji dhe pastaj të vazhdohet me digjitalizim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti. A pati edhe dikush tjetër? Deputeti Grainca.

BLERIM GRAINCA: Faleminderit!

Në bazë të kësaj që dëgjova, po rezulton se pakoja tenderuese do të jetë gati në qershor, para qershorit, në maj. OK edhe një muaj po themi, përafërsisht. Por, deri tash poenta kryesore ishte mungesa e buxhetit për vonesa. A mendoni, se tash në maj a qershor, keni kapacitete financiare, mundësi financiare për të startuar procesin, për arsye se, ju e dini, rishikimi bëhet në qershor. Me buxhetin që keni a mund të filloni procesin? A doni të loboni apo të kërkonin nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik rritje të buxhetit, ndarje me rishikim nga Qeveria, për arsye se po ju mbaj për fjale. Nuk bëhet pako tenderuese në qershor. Personalisht do të kërkoj shkarkimin e bordit të KPM-së.

Po ju pyes... unë do të kërkoj, se prej meje kërkon partia ime, çka jam duke bërë këtu? A mund ta bëjmë në qershor a s'mundemi. Nëse s'mundemi a është problem buxheti. Nëse është buxheti tregoni, shkojmë ta bëjmë kërkesën për buxhet, pyetje shumë e thjeshtë.

KRYESUESI: Tani, po përpiqem ta përmbyll krejt këtë dëgjim publik.

Aq sa u pa nga palët e ndryshme ka dyshime se edhe ligji mund të jetë pengesë për vonesën, respektivisht për moszbatimin e tij dhe pengesë për realizimin e projektit të digjitalizimit. Si proces, digjitalizimi e dimë se është mjaft i shtrenjtë, se ai do t'i prekë edhe mediet edhe buxhetin e shtetit dhe si i tillë duhet llogaritur se do të ketë shpenzime buxhetore.

Duke pasur parasysh se kemi burime të kufizuara financiare, megjithatë deri diku mund të justifikohet kjo vonesë, porse konsideroj se vonesa nuk është vetëm pasojë e mungesës së financave të mjaftueshme, është ngapak edhe proces për të cilin ka faj edhe faktori njeri, respektivisht institucionet përkatëse. Mendoj se është dashur më herët të përgatitet pakoja tenderuese. KPM-ja ankohet se nuk ka buxhet të mjaftueshëm. Këtë çështje do ta trajtojmë në komision dhe me të gjitha gjasat do të propozojmë, ashtu siç është edhe mendimi i një pjese edhe të anëtarëve të grupit punues, që të rishqyrtohet buxheti i Komisionit të Pavarur të Medieve.

Marrë në përgjithësi, mendoj se ligji nuk është i pazbatueshëm. Mendoj se ligji nuk është pengesë për procesin e digjitalizimit. Ligji nuk është i përsosur porse nuk është pengesë që ky proces të ecën përpara. Problemet që i ka e që i theksoi përfaqësuesi i AMPEK-ut në veçanti, mendoj se mund të zgjidhen fare lehtë vetëm duke e bërë KPM-ja një analizë të tregut paraprakisht, aq sa ka mundësi ta bëjë me kapacitetet që i ka, në mënyrë që kur të publikohet

pakoja tenderuese kjo analizë të jetë e gatshme edhe në përputhje me të pastaj edhe të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm.

KPM-ja e tha se nuk është zgjidhur me ligj, ka mbetur pezull, çështja e rehatimit të operatorëve të shërbimeve rajonale dhe lokale. Mendoj se kjo nuk qëndron. Në kapitullin 6, kufizimet operative të multiplexit, neni 18, paragrafi 2, thuhet se operatorët e multiplexit në nivel rajonal duhet të sigurojnë përfshirje me multiplex me rregullat masteri të të gjitha kanaleve rajonale dhe lokale të licencuara nga KPM-ja për transmetim tokësor në pajtim me politikat strategjike të KPM-së. Me fjalë tjera, ky nen ia hap rrugën KPM-së që ta zgjidhë ashtu siç do vet, siç e ka edhe në përputhje me strategjinë. Pavarësisht, se strategjia nuk është miratuar nga Qeveria ligji duhet të zbatohet dhe duhet t'i lëmë arsytetime e mëtutjeshme, duhet të vazhdojmë me hapa më të shpejtuar drejt realizimit të procesit të digjitalizimit. Jemi vonë prej afatit kur është dashur të kryhet krejt procesi në përputhje me marrëveshjen rajonale GE/06 të ITU-së, që është dashur të jetë 17 qershori i vitit 2015, që pothuajse dy vjet janë prej kohës kur është miratuar ligji edhe ai me shumë vonesë. Edhe procesi i mëtutjeshëm nuk guxon të vonohet. Jemi vonuar mjaftë.

Të gjitha institucionet duhet të marrin hapa të përshpejtuar, në mënyrë që ky ligj të jetësohet. Jam shumë i bindur, se do t'i adresojmë edhe krejt këto shqetësime që u thanë në rekomandimet tona drejtuar Kuvendit dhe Kuvendi pastaj do t'i ndërmarrë hapat e mëtutjeshëm, në mënyrë që edhe nëse ka nevojë edhe për buxhet shtesë.

Mendoj se nuk është boll e qartë çështja se si do të bëhet me rrjetin e transmetuesit publik. ky është, për mua, ndër problemet kryesore që ligji nuk i ka adresuar konkretisht, por se hapësira është e hapur, Qeveria duhet të punojë në drejtim qoftë të thithjes së mjeteve, qoftë të gjejë rrugë se si t'i rehatojë rrjetin dhe multiplexët për transmetuesit publikë, të tjerat besoj se janë të zgjidhshme.

Faleminderit për gjithë këtë dëgjim publik! Gjithë të mirat!

E përqatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë.